



REPUBLIKA E SHQIPERISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. Prot.

Vlorë, më 06.10.2016

Vendim
Nr. 38, datë 06.10.2016

**PËR ÇELJEN E NJË SEZONI TË POSAÇËM RIPROVIMESH NË
UNIVERSITETIN “ISMAIL QEMALI”, VLORË**

Në mbështetje të nenit **38** të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, nenit **27** të Statutit të Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, Senati Akademik në mbledhjen e datës 06.10.2016

VENDOSI:

1. Të miratojë çeljen e një sezoni të posaçëm riprovimesh për studentët e ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve, të cilët rezultojnë ngelës vetëm në 1 (një) lëndë.
2. T’i jepet e drejta e riprovimit studentit Zoto Mara, *Master Profesional* në mësimdhënie në gjuhën angleze, për pamundësi shëndetësore për të frekuentuar sezonin e vjeshtës dhe shlyer detyrimet lëndore.
3. Vendimi protokollohet dhe bëhen njoftimet përkatëse.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT AKADEMIK
Prof. Dr. Roland ZISI

Ky dokument përpilohet në 3 (tri) kopje.